

# Në kërkim të barazisë financiare: Qasja në financa për bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave etnike



Në kërkim të barazisë  
financiare: Qasja në financa  
për bizneset në pronësi të  
grave dhe të pakicave etnike

—  
Nëntor 2023

## — Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrje	5
2. Zotërimi i pronave dhe tokës	7
3. Shërbimet financiare në Kosovë	9
4. Përfundim dhe rekomandime	15
Aneksset	16

### **Deklaratë mohimi:**

"Ky raport u mundësua me mbështetjen e Popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e raportit mbetet përgjegjësi vetëm e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara."

Ky raport është shkruar fillimisht në gjuhën angleze.

## Shkurtimet

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
GAP	Instituti GAP
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme

## Përmbledhje ekzekutive

Ky raport synon të identifikojë pengesat financiare me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë, veçanërisht ato në pronësi të grave dhe pakicave etnike. Në Kosovë, NMVM-të dominojnë ekonominë, duke përbërë mbi 90% të të gjitha bizneseve aktive. Megjithatë, gratë zotërojnë vetëm 18% të këtyre bizneseve dhe individët nga pakicat etnike zotërojnë afërsisht 5%. Pavarësisht rëndësisë së tyre për ekonominë, këto biznese kanë vështirësi me qasjen në financa, ku vetëm një përqindje e vogël kanë marrë hua apo kanë linjë kredie. NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike përballen me disavantazhe edhe më të mëdha në qasjen ndaj shërbimeve financiare formale, gjë që pengon potencialin e tyre të rritjes.

Raporti identifikon dy grupe kryesore faktorësh që kontribuojnë në qasjen e kufizuar në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike: faktorët nga ana e kërkesës dhe ata nga ana e ofertës. Nga ana e kërkesës, studimet tregojnë se gratë ndërmarrëse kanë më shumë gjasa të ngurrojnë të aplikojnë për kredi, për shkak të perceptimit të dobët të pranueshmërisë për kreditim, barrierave financiare dhe frikës nga refuzimi. Adresimi i këtyre perceptimeve kërkon programe të edukimit financiar dhe fushata të synuara ndaj grave në mënyrë që të inkurajohen dhe të ndihmohen ato dhe individët nga pakicat etnike në aplikimin për financim bankar. Nga ana e ofertës, vështirësitë në përmbushjen e kërkesave dhe normave të kolateralit që diskriminojnë gratë dhe pakicat etnike e bëjnë të vështirë përfshirjen e tyre në sektorin financiar formal. Mungesa e pasurisë formale, pronësisë së tokës ose të drejtave të trashëgimisë pengon më tej mundësitë e tyre për të ofruar kolateral kur kërkojnë hua.

Statistikat kyçe:

- Gratë në Kosovë zotërojnë vetëm 15% të pronave, krahasuar me 74% që zotërohen nga burrat. Pjesa e mbetur e pronave prej 11% është në pronësi të personave/subjekteve juridike.
- Rreth 16% e numrit gjithsej të llogarive bankare të biznesit në Kosovë janë në pronësi të grave, 82% janë në pronësi të burrave dhe 2% janë të regjistruar në bashkëpronësi.
- Bizneset në pronësi të grave në Kosovë kanë 2.4 herë më pak hua sesa ato në pronësi të burrave. Konkretisht, sasia e borxhit aktiv për bizneset në pronësi të grave është 642.6 milionë euro, ndërsa për burrat është 1.53 miliardë euro. Për më tepër, bizneset në pronësi të grave zotërojnë 14.2 herë më pak depozita se ato në pronësi të burrave, apo vetëm 111.9 milionë euro krahasuar me bizneset në pronësi të burrave që zotërojnë 1.58 miliardë euro depozita.
- Gratë në Kosovë zotërojnë 42% të totalit të llogarive bankare individuale, krahasuar me 58% të llogarive individuale që zotërohen nga burrat.
- Gratë me llogari bankare individuale kanë 3.2 herë më pak borxh se burrat. Konkretisht, shuma e borxhit aktiv për llogaritë bankare individuale të zotëruara nga gratë është 364.9 milionë euro, ndërsa për burrat është 1.1 miliardë euro. Në mënyrë të ngjashme, gratë zotërojnë 2.42 herë më pak depozita sesa burrat në llogaritë e tyre individuale. Shuma e depozitave të zotëruara nga gratë është 829.5 milionë euro, ndërsa nga burrat është 2.01 miliardë euro.
- Të dhënat në lidhje me qasjen në financa nuk janë të ndara sipas etnisë nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) apo Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

Bazuar në gjetjet e analizës, ky raport ofron rekomandime për politikëbërësit, institucionet financiare dhe palët e tjera të interesuara për përmirësimin e qasjes në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike në Kosovë. Këto rekomandime përfshijnë implementimin e programeve të edukimit financiar, zhvillimin e fushatave të synuara, promovimin e praktikave jo-diskriminuese të huadhënies dhe përmirësimin e të drejtave pronësore për gratë dhe pakicat etnike.

# 1. Hyrje

Qasja në financa është përcaktues kyç i rritjes dhe qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në mbarë botën. Këto biznese janë shtytës të rëndësishëm të rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës, veçanërisht në vendet në zhvillim, ku ato përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë formale dhe asaj joformale. Megjithatë, mundësia e NMVM-ve për qasje në financa shpesh pengohet nga faktorë të ndryshëm si kolaterali i kufizuar, kostot e larta të transaksionit dhe mungesa e historisë kreditore formale.<sup>1</sup> NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike janë veçanërisht të cenueshme nga këto sfida, pasi ato shpesh përballen me pengesa shtesë si diskriminimi dhe rrjetëzimi i kufizuar.<sup>2</sup> Prandaj, adresimi i çështjes së qasjes në financa për këto grupe është vendimtar për nxitjen e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe uljen e varfërisë.

Ekonomia e Kosovës dominohet nga NMVM-të, të cilat përbëjnë më shumë se 90% të të gjitha bizneseve në vend. Sipas një studimi hulumtues të Institutit GAP, gratë zotërojnë vetëm 18% të bizneseve në Kosovë; nga këto 98.9% janë ndërmarrje mikro, 0.6% janë ndërmarrje të vogla dhe 0.05% janë ndërmarrje të mesme.<sup>3</sup> I njëjti studim tregoi se komunitetet e pakicave etnike në Kosovë zotërojnë 5.4% të bizneseve në Kosovë; nga të cilat 97.9% janë ndërmarrje mikro, 1.8% janë të vogla dhe 0.2% janë ndërmarrje të mesme.<sup>4</sup>

Programi për Reforma në Ekonomi identifikon qasjen e kufizuar në financa, veçanërisht për NVM-të, si një nga pengesat kryesore për konkurrueshmërinë dhe rritjen, si dhe diskuton shkaqet dhe kufizimet në disa pika.<sup>5</sup> Në nivel makroekonomik përmendet përqendrimi i lartë i sektorit bankar dhe niveli i lartë i normave të huadhënies, të cilat megjithatë janë ulur paksa në vitet e fundit.<sup>6</sup> Megjithatë, ky program nuk i referohet veçanërisht bizneseve në pronësi të grave apo të pakicave etnike.

## 1.1. Metodologjia

Përmes këtij raporti, Instituti GAP synon të analizojëshërbimet financiare bankare për të dhënë një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale të qasjes në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, raporti mëton të identifikojë disa nga barrierat kryesore për qasjen në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike në Kosovë; të vlerësojë mjedisin e politikave dhe ndikimin që kanë ato në qasjen në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike në Kosovë; dhe të ofrojë rekomandime për politikëbërësit, institucionet financiare dhe palët e tjera të interesit se si të përmirësohet qasja në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike në Kosovë. Për arritjen e këtyre objektivave të hulumtimit janë përdorur metodat e hulumtimit cilësor dhe sasior. Instituti GAP ka shqyrtuar literaturën ekzistuese për të identifikuar barrierat kryesore për qasjen në financa për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike, duke përfshirë revista akademike, dokumente politikash, raporte dhe burime të tjera relevante. Të dhënat primare janë marrë përmes kërkesave për të dhëna drejtuar institucioneve financiare dhe palëve të tjera të interesuara.<sup>7</sup> Të dhënat

1 Grupi i Bankës Botërore. [Përmirësimi i qasjes në financa për NVM-të: Mundësitë përmes praktikave të raportimit kreditor, huadhënies së siguar dhe paaftësisë paguese](#), ff. 5-9, 2018.

2 Po aty.

3 Instituti GAP. [Profilat e bizneseve: Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë](#), 2023.

4 Po aty.

5 Qeveria e Kosovës. [Programi për Reforma në Ekonomi 2023-25](#), ff. 32, 33, 65.

6 Po aty, ff. 112, 114, 117.

7 Vetëm një bankë komerciale ka ofruar të dhëna të ndara sipas pakicave etnike.

për pronësinë e aseteve, pronës dhe tokës janë marrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Këto të dhëna janë përdorur për të ekzaminuar numrin e grave që mund të plotësojnë kërkesat e kolateralit për të marrë para hua nga institucionet financiare. Instituti GAP ka kërkuar të dhëna të detajuara të ndara sipas gjinisë dhe pakicave etnike për zotërimin e llogarive bankare dhe historinë kreditore nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), mirëpo, ata kanë ofruar informacione vetëm për vlerat aktuale në total. Të njëjtat të dhëna u kërkuan nga Shoqata e Bankave të Kosovës, mirëpo Instituti GAP nuk arriti t'i sigurojë këto të dhëna as nga ky subjekt. Tutje, Instituti GAP ka siguruar dhëna nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) për numrin e huave të garantuara nga ky institucion në rastet kur gratë nuk i plotësojnë kërkesat e kolateralit për huadhënie.

## 1.2. Shqyrtimi i literaturës mbi bizneset në pronësi të grave në shkallë rajonale dhe globale

Në shumë ekonomi në zhvillim, gratë ende përballen me sfida të ndjeshme në qasjen dhe kontrollin e burimeve si kreditimi, toka dhe inputet prodhuese, gjë që krijon disparitet gjinor.<sup>8</sup> Kjo vlen edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto pabarazi strukturore kufizojnë aftësinë e grave për të qenë produktive si prodhuese ose ndërmarrëse dhe shpesh i detyrojnë gratë, dhe jo burrat, të merren me veprimtari biznesi me vlerë të ulët në sektorë më të vegjël dhe më pak dinamikë.<sup>9</sup> Pabarazitë në pronësinë dhe posedimin e tokës vazhdojnë për shkak të diskriminimit ligjor në të drejtat e trashëgimisë dhe pronësisë dhe normave patriarkale dhe praktikave socio-kulturore të rrënjosura në të drejtën zakonore.<sup>10</sup> Këto çështje shpesh përkeqësohen nga mungesa e ndërgjegjësimit për të drejtat legjitime.

Shumë studime pajtohen se mungesa e qasjes së pandërprerë në opsionet e financimit për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pakicave etnike përbën një dobësi të ndjeshme të tregut. Mirëpo, nuk ka konsensus në lidhje me shkaqet që nxisin këtë çështje, megjithëse shumica e argumenteve mund të kategorizohen në dy grupe, përkatësisht në anën e kërkesës dhe të ofertës. Nga ana e kërkesës, studimet kanë treguar se gratë ndërmarrëse, veçanërisht ato që menaxhojnë një NMVM kanë më shumë të ngjarë të mos aplikojnë për hua, krahasuar me burrat.<sup>11</sup> Në Shqipëri, studimet kanë treguar se gratë ndërmarrëse kanë më shumë të ngjarë të hezitojnë të aplikojnë për t'u futur në tregun kreditor për shkak të perceptimit të dobët të pranueshmërisë për kreditim dhe frikës nga refuzimi.<sup>12</sup> Pavarësisht mungesës së praktikave diskriminuese në huadhënie, bizneset në pronësi të grave kanë norma më të ulëta të aplikimit për hua në krahasim me homologët burra.<sup>13</sup> Për më tepër, hezitimi ka vazhduar përkundër mungesës së praktikave diskriminuese të huadhënies, gjë që sugjeron se hezitimi për të aplikuar për t'u futur në tregun kreditor nuk është thjesht një përgjigje ndaj diskriminimit nga institucionet financiare. Në mënyrë të ngjashme, studime të tjera evidentojnë diferencë të ndjeshme në normat e aplikimit për hua për bizneset në pronësi të grave krahasuar me bizneset në pronësi të burrave dhe sugjerojnë se gratë kanë më shumë të ngjarë të bëjnë vetë-përzgjedhje për të mos aplikuar për t'u futur në tregun kreditor për shkak të frikës nga refuzimi.<sup>14</sup>

8 Kabeer, N. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Një analizë kritike e Objektivit të tretë të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. *Gjinia & Zhvillimi*, 25(1), 13–29, 2017.

9 Gender Budget Watchdog Network. [Running up that hill: economic strengthening of women in Western Balkans](#), f.13, 2022.

10 Grupi i Bankës Botërore. 2015. [Strategjia Gjinore e Grupit të Bankës Botërore \(VF16–23\): Barazia gjinore, ulja e varfërisë dhe rritja përfshirëse](#), ff. 52, 53.

11 Stefani, M.L. and Vacca, V.P. [Credit Access for Female Firms: Evidence from a Survey on European SMEs](#), ff. 18–19, 2023. SSRN Electronic Journal; Sena, V., Scott, J. and Roper, S. (2012). [Gender, borrowing patterns and self-employment: some evidence for England](#). *Small Business Economics*, 38(4), ff.467–480.

12 Ramadani, V. [The Woman Entrepreneur in Albania: An Exploratory Study on Motivation, Problems and Success Factors](#), 2015.

13 Banka Botërore. [Drejt barazisë gjinore në Shqipëri: Ndryshimi i mendësive përmes reformës institucionale](#), 2020.

14 Moro, A., Wisniewski, T. P. and Mantovani, G. M. (2017). [Does a manager's gender matter when accessing credit?](#) Evidence from European data. *Journal of Banking and Finance*, 80 ff. 119–134; Galli, E., Mascia, D.V. and Rossi, S.P.S. (2020). [Bank credit constraints for women-led SMEs: Self-restraint or lender bias?](#) *European Financial Management*, 26(4), ff.1147–1188.


Ekziston një mospërputhje ndërmjet nevojave të NMVM-ve dhe ofrimit të shërbimeve financiare. Nga ana e ofertës, një studim i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) konstatoi se gratë kanë më shumë gjasa të përjashtohen nga sektori financiar formal kur ligjet dhe normat diskriminojnë gratë dhe gratë kanë pjesëmarrje më të ulët në tregun e punës.<sup>15</sup> Perceptimi i riskut të bankave shpesh kontribuon në qasjen e kufizuar në financa për NVM-të e grave dhe të pakicave etnike.<sup>16</sup> Këto praktika diskriminuese, qofshin me apo pa vetëdije, mund të çojnë në kushte të pabarabarta për lojë që pengojnë rritjen dhe zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve. Gratë gjithashtu kanë më shumë gjasa të drejtohen nga punësimi jo-formal.<sup>17</sup> Kjo mund të pengojë ndjeshëm aftësinë e tyre për të aplikuar për kredi, dhe për të marrë kredi, nga institucionet financiare si pjesë e strategjive të tyre të shmangies së riskut.

Ka shumë pak të dhëna për qasjen e pakicave etnike në shërbimet financiare në Kosovë, gjë që e bën të vështirë nxjerrjen e çfarëdo përfundimi domethënës nga datasetet e përdorura në literaturën e shqyrtuar. Megjithatë, studimet e lartpërmendura sugjerojnë se në përgjithësi, faktorët shtytës të kërkesës dhe ofertës që qëndrojnë prapa përjashtimit financiar janë të aplikueshëm për të gjitha grupet e marginalizuara. Në mënyrë të ngjashme, veprimet e mundshme të politikave që mund të ndreqin këtë përjashtim mund të aplikohen edhe për pakicat etnike.

## 2. Zotërimi i pronave dhe tokës

Një sfidë e zakonshme me të cilën përballen bizneset në pronësi të grave është përmbushja e kërkesave për kolateral. Praktikant tradicionale të huadhënies shpesh kërkojnë kolateral për të siguruar një kredi. Të dhënat zyrtare nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) sugjerojnë se 74% e pronave private në Kosovë janë në pronësi të burrave, 15% janë në pronësi të grave dhe 11% janë në pronësi të personave/subjekteve juridike. Kjo tregon se fare pak gra zotërojnë prona, krahasuar me shumicën dërrmuese që zotërohen nga burrat. Niveli i ulët i zotërimit të pronave krijon probleme të ndryshme ekonomike dhe sociale për gratë, siç është mungesa e kolateralit të mjaftueshëm për të marrë hua.<sup>18</sup>

**Figura 1.** Numri i njësive kadastrale në Kosovë, sipas gjinisë<sup>19</sup>




<sup>15</sup> Morsy, H. and Youssef, H. [Access to finance – mind the gender gap](#), f.19. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

<sup>16</sup> Po aty, 2017.

<sup>17</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës. [Gratë dhe burrat në ekonominë jo-formale: Një pamje statistikore](#), ff. 1,2, 2018.

<sup>18</sup> RrGK. [Analiza Gjimore e Kosovës](#), f. 16, 2018.


<sup>19</sup> Deri në prill 2023.

**Figura 2.** Numri i njësive kadastrale nga viti 2017 deri në vitin 2022, sipas gjinisë

Burimi: Agjencia Kadastrale e Kosovës

Numri i njësive kadastrale në pronësi të grave duket se ka mbetur i njëjtë nga viti 2017 deri në vitin 2022, me një diferencë prej 6,500 njësive mesatarisht. Nga ana tjetër, numri i njësive kadastrale në pronësi të burrave duket se është rritur më shumë gjatë të njëjtës periudhë, me një diferencë prej 34,800 njësi rritje mesatarisht. Rritja e numrit të njësive kadastrale ndodh për shkak të blerjes, trashëgimisë apo legalizimit të këtyre njësive çdo vit.

Edhe pse legjislacioni i Kosovës garanton të drejta të barabarta për burrat dhe gratë në Kosovë, deri më sot, burrat trashëgojnë më shumë prona sesa gratë (shih figurën 3). Sipas të dhënave të AKK-së, burrat trashëgojnë përafërsisht 80% të të gjitha pronave çdo vit në Kosovë. Në vitin 2017, burrat trashëguan 15,055 (82%) të pronave private, krahasuar me numrin e pronave private të trashëguara nga gratë 3,236 (18%). Trendi ka vazhduar në mënyrë të ngjashme përgjatë viteve (shih figurën 3). Në vitin 2022, burrat trashëguan 11,639 prona më shumë sesa gratë.

**Figura 3.** Numri i grave dhe burrave që trashëguan pronë<sup>20</sup> në Kosovë nga viti 2017 deri në vitin 2022

Burimi: Agjencia Kadastrale e Kosovës

<sup>20</sup> Shënim: Një person (burrë apo grua) potencialisht mund të trashëgojë më shumë se një njës kadastrale. Në mënyrë të ngjashme, një njësi kadastrale mund të ketë më shumë se një trashëgimtar.



### 3. Shërbimet financiare në Kosovë

Sistemi bankar i Kosovës rregullohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), e cila mbikëqyr operacionet e bankave komerciale dhe siguron stabilitet dhe pajtueshmëri me rregulloret përkatëse.<sup>21</sup> Janë 12 institucione bankare të licencuara që operojnë në Kosovë, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë marrjen e depozitave, huadhënien, shërbimet e pagesave dhe produktet investuese.<sup>22</sup>

#### 3.1. Llogaritë e biznesit

Numri i përgjithshëm i llogarive bankare të biznesit në Kosovë është 127,652. Nga ky total, 104,461 (81,8%) llogari biznesi zotërohen nga burrat, ndërsa 21,247 (16,6%) zotërohen nga gratë dhe 1,944 (1,6%) janë të regjistruara në emër të grave dhe burrave së bashku. Sipas këtyre të dhënave, burrat zotërojnë pesë herë më shumë llogari bankare biznesi sesa gratë. Kjo është e ndryshme nga pjesa e llogarive bankare individuale ku hendeku është më i vogël.


**Figura 4.** Numri i llogarive të biznesit, sipas gjinisë, në mars 2023



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës


Numri i huave të biznesit për bizneset në pronësi të burrave prej 24,546 (74%) është dukshëm më i madh në krahasim me ato për bizneset në pronësi të grave prej 21,247 (25%). Për më tepër, nga totali i shumës së borxhit aktiv për bizneset, burrat kanë përsipër 69% (1.53 miliardë euro), krahasuar me gratë që kanë përsipër 29% (642 milionë euro) dhe 2% (35 milionë) është në barrë të grave dhe burrave së bashku.

**Figura 5.** Numri i kredive të biznesit, sipas gjinisë së pronarit të biznesit




21 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës](#), 2010

22 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. [Institucionet financiare të licencuara](#), 2023

**Figura 6.** Shuma e borxhit aktiv, sipas gjinisë së pronarit të biznesit

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Të dhënat nga BQK-ja nxjerrin në pah një disparitet të ndjeshëm gjinor në pronësinë e depozitave të biznesit dhe shumës së borxhit aktiv. Një shumë jo-proporcionale e depozitave të biznesit është e përqendruar në duart e burrave. Bizneset në pronësi të grave kanë depozita në vlerën 111.9 milionë euro, ndërsa bizneset me pronësi të burrave kanë depozita në vlerën 1.58 miliardë euro. Dispariteti ndërmjet vlerës së depozitave dhe vlerës së borxhit aktiv mund të kufizojë aftësinë për të filluar ose zgjeruar bizneset, mundësitë e investimit, qasjen në kredi dhe të kontribuojë në rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik<sup>23</sup>.

**Figura 7.** Shuma e depozitave të biznesit, sipas gjinisë së pronarit të biznesit

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

23 [Dokument pune i FMN-së. Financat, rritja dhe pabarazia](#), ff. 20–22, 2021

## Rast studimor: Llogaritë bankare të bizneseve në pronësi të pakicave

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për bizneset në pronësi të pakicave, vetëm një nga bankat komerciale në Kosovë ofroi disa informata relevante në këtë drejtim. Sipas të dhënave të ofruara nga kjo bankë, janë 2,317 (10%) llogari biznesi në pronësi të grave, 19,655 (85%) llogari biznesi në pronësi të burrave dhe 1,160 (5%) në pronësi të përbashkët të burrave dhe grave. Nga gjithsej 23,132 llogari bankare në këtë institucion, 416 (2%) janë në pronësi të pakicave etnike në Kosovë. Nga totali i llogarive të zotëruara nga pakicat etnike, 320 (78%) i përkasin individëve të komunitetit serb, 79 (19%) i përkasin komunitetit turk, 16 (3.8%) i përkasin komunitetit boshnjak dhe vetëm një (0.2%) i përket një individi të komunitetit egjiptian. Bazuar në këto të dhëna, janë miratuar të dhjetë aplikimet për hua biznesi nga individë të komunitetit boshnjak gjatë periudhës 2017–2022. Shuma totale e huas është 37,880 euro, me një mesatare prej 3,638 euro. Nga gjithsej 76 aplikime për hua biznesi nga individë të komunitetit serb, janë miratuar 64 (84%) me një shumë totale prej 6.1 milionë euro dhe me një mesatare prej 90,153 euro. Në fund, nga gjithsej 56 aplikime për hua biznesi nga individë të komunitetit turk, janë miratuar 42 (75%) me një shumë totale të huas prej 5.37 milionë euro dhe një mesatare prej 48,858 euro.


**Tabela 1.** Huat për biznese të marra nga pakicat etnike në Kosovë nga viti 2017 deri në vitin 2022, sipas gjinisë

Pakica	Gjinia	Numri i aplikimeve për hua	Numri i huave të miratuara	Shuma totale e huazuar	Shuma mesatare e huazuar
Boshnjak	Gra	n/a	n/a	n/a	n/a
	Burra	10	10	€ 37,880	€ 3,638
	Burra dhe gra	n/a	n/a	n/a	n/a
Serb	Gra	1	1	€ 20,050	€ 20,050
	Burra	68	56	€ 6,100,869	€ 90,153
	Burra dhe gra	7	7	€ 26,000	€ 3,200
Turk	Gra	4	3	€ 60,000	€ 20,000
	Burra	50	38	€ 5,308,302	€ 121,575
	Burra dhe gra	2	1	€ 5,000	€ 5,000

### 3.2. Llogaritë individuale

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, gjithsej janë 1,340,035 llogari bankare individuale dhe 127,652 llogari biznesi.<sup>24</sup> Nga totali i llogarive bankare individuale, 559,101 (42%) janë llogari individuale në pronësi të grave; ndërsa 780,934 (58%) janë llogari individuale në pronësi të burrave.


**Figura 8.** Numri i llogarive bankare individuale, sipas gjinisë




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Ndonëse pjesa e llogarive bankare individuale është deri diku e ngjashme për gratë dhe burrat, ka një dallim në numrin e kredive individuale. Aktualisht, burrat zotërojnë 780,934 (58%) llogari bankare individuale, krahasuar me 559,101 (42%) llogari bankare individuale në pronësi të grave. Nga ana tjetër, janë 111,355 (68%) hua individuale të pashlyera që janë marrë nga burrat, në krahasim me 52,137 (32%) hua individuale që janë marrë nga gratë.

**Figura 9.** Numri i huave individuale, sipas gjinisë




**Figura 10.** Shuma e borxhit aktiv, sipas gjinisë



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës


Gratë me llogari individuale kanë marrë 3.2 herë më pak hua se burrat. Koncretisht, shuma e borxhit aktiv për llogaritë bankare individuale të zotëruara nga gratë është 364.9 milionë euro, ndërsa për burrat është 1.1 miliardë euro. Në mënyrë të ngjashme, gratë zotërojnë 2.42 herë më pak depozita sesa burrat. Shuma e depozitave të zotëruara nga gratë është 829.5 milionë euro, ndërsa nga burrat është 2.01 miliardë euro.

<sup>24</sup> Të dhënat janë aktuale nga prilli 2023. Të dhënat janë marrë nga Banka Qendrore e Kosovës përmes kërkesës për qasje në të dhëna.

**Figura 11. Shuma e depozitave individuale, sipas gjinisë**

### 3.3. Historia kreditore dhe kolaterali


Mungesa e kolateralit e bën shumë të vështirë për gratë përmbushjen e kërkesave për të marrë para hua nga institucionet financiare. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është institucion i krijuar për të trajtuar këtë problem dhe për të ndihmuar me garanci për ata që nuk mund të përballojnë ofrimin e kolateralit.<sup>25</sup> Në gjashtë vitet e fundit (2016–2022), ky institucion ka ndihmuar me ofrimin e garancisë për 12,653 hua, nga të cilat 1,725 (14%) janë për biznese në pronësi të grave. Shuma totale e huazuar që FKGK ka garantuar pjesërisht nga viti 2016 deri në vitin 2022 për bizneset në pronësi të grave është 63.3 milionë euro ndërsa për bizneset në pronësi të burrave është 458.9 milionë euro. Shuma totale e garancisë për bizneset në pronësi të grave është 34.6 milionë euro, që është 54.6% e shumës totale të huazuar që është garantuar për gratë dhe 22.5% e shumës totale të garancisë në krahasim me atë të burrave. Nga ana tjetër, shuma e garancisë për bizneset në pronësi të burrave është 243.3 milionë euro, 53% e shumës totale të huazuar që është garantuar për burrat ose 87.5% e shumës totale të garancisë në krahasim me atë të grave. Nga shuma totale e huadhënies për biznes që është garantuar për periudhën 2016–2022, rreth 41% e bizneseve në pronësi të burrave dhe 37,3% e bizneseve në pronësi të grave ishin të përqendruara në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndjekur nga një pjesë shumë më e vogël në industrinë përpunuese, ndërtimtari, etj. Raporti ndërmjet huave për bizneset në pronësi të burrave dhe huave të garantuara për bizneset në pronësi të grave mbetet i ngjashëm gjatë këtyre gjashtë viteve (shih Aneksin 1). Kjo mbetet problem pasi gratë janë të nën-përfaqësuara në këtë aspekt dhe shuma e huave të garantuara për bizneset në pronësi të grave është dashur të rritet gjatë viteve përmes masave afirmative. Këto masa afirmative përfshijnë dritaren e grave në biznes dhe dritaren për start-up. Rritja më e madhe e shumës së huas për bizneset në pronësi të grave, siç është paraqitur në Figurën 12, ka ndodhur për shkak të masave ekonomike që Qeveria e Kosovës ka implementuar për të luftuar paqëndrueshmërinë ekonomike të shkaktuar nga pandemia e COVID-19.

**Figura 12. Shuma e garancisë për huat e biznesit nga viti 2016 deri në vitin 2022, sipas gjinisë së pronarit**

25 [Ligji nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore](#), 2016.

Sipas hulumtimit të GAP, bizneset në pronësi të grave janë të përfaqësuara më së shumti në tregtinë me shumicë dhe pakicë (27%), veprimtari shërbimi (17.1%), industrinë përpunuese (12.4%), akomodim dhe shërbime ushqimi (7.3%) dhe bujqësi, pylltari dhe peshkim (6.5%).<sup>26</sup> Në mënyrë të ngjashme, nga shuma totale e huave të garantuara nga FKGK për bizneset në pronësi të grave nga viti 2016 deri në vitin 2022, mbi 80% ishin biznese që operojnë në tregtinë me shumicë dhe pakicë (37.3%), industrinë përpunuese (16.4%), bujqësi, pylltari dhe peshkim (12.6%), akomodim dhe shërbime ushqimi (7.9%), veprimtari të tjera shërbimi (5.8%) dhe ndërtimtari (4.1%). Ndërsa sektorët me më pak kredi të garantuara për bizneset në pronësi të grave nga ky institucion janë veprimtaritë e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të padiferencuara – prodhimi i ekonomive familjare për përdorim vetjak (0.1%), si dhe industria nxjerrëse (0.1%).

**Figura 13. Sektorët ekonomikë me shumën më të madhe të garantuar të huas për biznes, nga viti 2016 deri në vitin 2022**



Burimi: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

<sup>26</sup> Instituti GAP. [Profili i bizneseve: Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë, 2023.](#)

## 4. Përfundim dhe rekomandime

Ky raport synon të ofrojë njohuri më të thella për pengesat financiare me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë në qasje në financa, me fokus të veçantë në ato në pronësi të grave dhe pakicave etnike. Gjetjet shpërfaqin një mungesë shqetësuese të përfaqësimit të grave dhe pakicave etnike si pronarë biznesi, duke treguar nevojën urgjente për ndërhyrje të synuara (siç janë masat afirmative) për të adresuar këto disparitete. Hendeku i madh gjinor në pronësinë e bizneseve është i dukshëm nga të dhënat e paraqitura, ku gratë zotërojnë vetëm 18% të totalit të bizneseve në Kosovë, ndërsa komunitetet pakicë etnike zotërojnë afërsisht 5%. Ky nën-përfaqësim mund t'u atribuohet faktorëve të ndryshëm socio-ekonomikë dhe kulturorë, duke nxjerrë në pah nevojën për shqyrtim më të thellë të barrierave sistemore me të cilat përballen këto grupe të marginalizuara. Mungesa e pasurisë formale dhe pronësisë së tokës përbën pengesë të ndjeshme për qasjen në financa, pasi kufizon disponueshmërinë e kolateralit dhe pengon aftësinë për të përmbushur kërkesat e kolateralit për sigurimin e huave apo linjave të kredisë.

Statistikat kryesore të paraqitura në raport demonstrojnë disparitetet që ekzistojnë në qasjen në financa për gratë. Për shembull, gratë zotërojnë vetëm 15% të pronave në Kosovë, ndërsa burrat zotërojnë 74%, dhe pjesa e mbetur prej 11% zotërohen nga personat juridikë. Kur bëhet fjalë për llogaritë bankare të biznesit, 81.8% zotërohen nga burrat, 16.6% nga gratë dhe 1.6% janë të regjistruara nga burrat dhe gratë bashkë. Bizneset në pronësi të grave në Kosovë kanë marrë 2.4 herë më pak të hua sesa ato në pronësi të burrave. Konkretisht, shuma e borxhit aktiv për bizneset në pronësi të grave në bankat komerciale në Kosovë është 642.6 milionë euro, ndërsa për burrat është 1.53 miliardë euro. Në mënyrë të ngjashme, gratë si pronare të biznesit zotërojnë 14.2 herë më pak depozita sesa burrat. Shuma e depozitave të zotëruara nga bizneset në pronësi të grave është 111.9 milionë euro, ndërsa bizneset në pronësi të burrave zotërojnë 1.58 miliardë euro depozita. Në gjashtë vitet e fundit, Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë ka garantuar 1,735 hua për bizneset në pronësi të grave. Shuma totale e huazuar që është garantuar nga viti 2016 deri në vitin 2022 për bizneset në pronësi të grave është 63.3 milionë euro, ndërsa për bizneset në pronësi të burrave është 458.9 milionë euro. Ndonëse FKGK ka kontribuar jashtëzakonisht në edukimin financiar dhe qasjen në financa për gratë, duke ofruar garanci për kapërcimin e sfidës së kërkesave për kolateral, ende ka shumë punë që duhet bërë nga politikëbërësit. Një kufizim i madh i vërejtur në këtë analizë është mungesa e të dhënave të zbërthyera sipas gjinisë dhe pakicave etnike, gjë që pengon vlerësimin e saktë të sfidave specifike me të cilat ballafaqohen bizneset në pronësi të grave dhe pakicave etnike gjatë qasjes në financa. Adresimi i këtij boshllëku të të dhënave është i domosdoshëm, pasi të dhënat përbëjnë themelin për politikëbërje të bazuar në fakte dhe ndërhyrje të synuara për të zbutur disparitetet financiare. Së këndejmi, Qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës do të duhej të kenë prioritet mbledhjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e të dhënave të zbërthyera sipas gjinisë dhe të dhënave për pakicat etnike për të informuar politikën fiskale dhe praktikën e institucioneve financiare.

Instituti GAP u rekomandon politikëbërësve, institucioneve financiare dhe palëve të tjera të interesuara të promovojnë edukimin financiar dhe përfshirjen për gratë duke ofruar financim të synuar dhe programe investimi, si dhe duke krijuar mundësi për mentorim dhe rrjet-formim. Kjo mund të bëhet duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për të edukuar gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara mbi të drejtat e tyre për të zotëruar tokë dhe pasuri, dhe duke shpërndarë informacion në lidhje me kornizat ligjore, të drejtat e trashëgimisë dhe proceset e regjistrimit të pronës. Tutje, do të duhej të bëhen përpjekje për të bashkëpunuar me parinë e komunitetit, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet lokale për të siguruar kuptim sa më të përhapur të këtyre të drejtave. Kjo do të ofrojë njohuri të vlefshme për sfidat specifike me të cilat përballen këto komunitete dhe do të përmirësojë qasjen e tyre në financa.

# Anekset

## Aneksi 1. Numri i huave, shuma e huas dhe shuma e garancisë nga FKGK nga viti 2016 deri në vitin 2022, sipas gjinisë

Viti	Nr.	Shuma e huas	Shuma e garancisë	% e shumës totale të huas së garantuar
<b>Gra</b>	1,735	€ 63,378,452	€ 34,640,726	12.5%
2016	8	€ 357,000	€ 178,500	8.4%
2017	87	€ 2,618,426	€ 1,270,813	10.1%
2018	159	€ 5,156,600	€ 2,514,900	9.4%
2019	245	€ 7,999,946	€ 3,879,123	12.0%
2020	374	€ 12,276,690	€ 6,047,783	15.3%
2021	553	€ 22,837,574	€ 14,687,394	13.1%
2022	309	€ 12,132,215	€ 6,062,212	11.6%
<b>Burra</b>	10,918	€ 458,967,669	€ 243,359,132	87.5%
2016	78	€ 4,148,500	€ 1,955,450	91.6%
2017	640	€ 23,440,900	€ 11,308,005	89.9%
2018	1,276	€ 50,850,711	€ 24,164,556	90.6%
2019	1,471	€ 58,657,062	€ 28,480,402	88.0%
2020	1,994	€ 68,807,538	€ 33,509,084	84.7%
2021	3,495	€ 160,048,379	€ 97,812,130	86.9%
2022	1,964	€ 93,014,578	€ 46,129,505	88.4%
<b>Gjithsej</b>	<b>12,653</b>	<b>€ 522,346,121</b>	<b>€ 277,999,858</b>	

Burimi: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore



**Aneksi 2. Huat e garantuara nga FKGK për bizneset në pronësi të grave nga viti 2016 deri në vitin 2022, sipas sektorëve të ekonomisë**

**Shuma totale e garantuar e huave të biznesit (2016–2022)**

	Bizneset në pronësi të grave		Bizneset në pronësi të burrave	
Shërbime akomodimi dhe ushqimi	€ 4,996,382.84	7.9%	€ 30,629,538.85	6.7%
Veprimtari të ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbime të padiferencuara – Prodhim i ekonomive familjare për përdorim vetjak	€ -	0.0%	€ 238,500.00	0.1%
Veprimtari të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	€ 1,805,300.00	2.8%	€ 12,401,787.82	2.7%
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	€ 7,987,512.58	12.6%	€ 27,781,930.83	6.1%
Arte, argëtim dhe rekreacion	€ 242,556.05	0.4%	€ 2,739,269.73	0.6%
Ndërtim	€ 2,571,055.48	4.1%	€ 43,646,283.81	9.5%
Arsim	€ 1,457,171.08	2.3%	€ 1,436,900.00	0.3%
Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	€ -	0.0%	€ 2,512,100.00	0.5%
Veprimtari financiare dhe të sigurimeve dhe financim i pensioneve	€ 152,000.00	0.2%	€ 993,500.00	0.2%
Veprimtari të shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	€ 1,517,249.21	2.4%	€ 5,812,275.68	1.3%
Informim dhe komunikim	€ 1,846,995.31	2.9%	€ 8,587,677.21	1.9%
Industri përpunuese	€ 10,414,180.01	16.4%	€ 94,045,131.47	20.5%
Industri nxjerrëse (miniera dhe gurorë)	€ 107,000.00	0.2%	€ 615,200.00	0.1%
Veprimtari të tjera shërbimi	€ 3,671,309.89	5.8%	€ 13,737,862.58	3.0%
Analizë profesionale, shkencore dhe teknike	€ 1,081,467.89	1.7%	€ 8,797,207.61	1.9%
Administratë publike dhe mbrojtje, sigurime sociale të detyrueshme	€ 65,000.00	0.1%	€ 795,500.00	0.2%
Veprimtari të patundshmërive	€ 120,000.00	0.2%	€ 810,000.00	0.2%
Transport dhe magazinim	€ 1,223,123.86	1.9%	€ 14,012,798.22	3.1%
Furnizim me ujë, kanalizime, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve	€ 501,000.00	0.8%	€ 1,096,500.00	0.2%
Tregti me shumicë dhe me pakicë	€ 23,619,147.75	37.3%	€ 188,277,704.87	41.0%

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e FKGK-së


Instituti GAP është think-tank i themeluar në vitin 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,  
10000 Prishtine

+383 38 609 339

info@institutigap.org



**Në kërkim të barazisë financiare:  
Qasja në financa për bizneset  
në pronësi të grave dhe  
të pakicave etnike**